



PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 22.08.2024 në “Shtëpinë e Kulturës” në Han të Elezi i organizuar me gratë. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 15:00 prezent ishin 18 qytetarë. Prezent ishte Kryetari i Komunës z. Mehmet Ballazhi.

Takimin e kryesoj Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj. **Lindita Ballazhi**.

Rendi i Punës

1. Projekt Buxheti për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027.

Lindita Ballazhi para se me vazhduar me prezantimin e buxhetit fillimisht kërkoj nga Kryetari i Komunës për një fjalë përshëndetëse, pastaj do të bëjë prezantimin e buxhetit.

Mehmet Ballazhi është obligim ligjorë që të organizojmë dëgjim buxhetorë për planifikimin buxhetorë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027. Është mirë që pjesëmarrja qytetare me qenë më e madhe në mënyrë që me i dhënë propozimet e tyre. Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ky buxhet është ndarë në kategoritë buxhetore. Për paga dhe shtesa buxheti i planifikuar është në shumë prej 2,188,542.00 €, mallra dhe shërbime 584,500.00 €, shpenzime komunale 94,000.00 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00 €, investime kapitale 605,415.00 €. Në kuadër të kësaj shume buxhetore po mundohemi që me bërë realizimin e projekteve.

Lindita Ballazhi Buxheti paraqet një instrument financiar apo një plan njëvjeçar për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore të Organizatës Buxhetore. Fazat nëpër të cilat i kemi kaluar deri në hartimin e buxhetit janë:

- Themelimi i 2 grupeve punuese: Grup punues për hartimin e dëgjimeve buxhetore dhe Grupi punues për hartimin e KAB-it 2025-2027.
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2025 me kufijtë fillestar buxhetor,
- Hartimi i KAB-it me grupin punues,
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore për KAB 2025-2027,
- Miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i KAB-it në Departamentin e Buxhetit - MFPT,
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2025 me kufijtë final buxhetor,
- Hartimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore për Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Dorëzimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 para datës 01.09.2024 në Kuvend Komunal,

- Miratimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Departamentin e Buxhetit - MFPT.

Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ky buxhet është ndarë në kategoritë buxhetore. Për paga dhe shtesa buxheti i planifikuar është në shumë prej 2,188,542.00 €, mallra dhe shërbime 584,500.00 €, shpenzime komunale 94,000.00 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00 €, investime kapitale 605,415.00 €. Sa i përket listës së projekteve kapitale, i kemi listuar të gjitha projektet të cilat janë miratuar nga Asambleja Komunale në KAB 2025-2027, po ne jemi të hapur edhe për propozime të reja. Më pas do të hartojmë Listën e propozimeve të qytetarëve dhe të njëjtën listë do ta dorëzojmë së bashku me Buxhetin në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim të mëtutjeshëm.

Alma Ballazhi është mirë me pasur një librari në Komunën tonë, propozoj që të rregullohen shtyllat elektrike në Lagje të Re.


Besmira Daci propozoj që të shtohen hapësirat e punës në QKMF apo të bëhet edhe ndonjë aneks i QKMF-së.

Lindita Ballazhi a keni edhe ndonjë propozim përveç këtyre propozimeve, nëse nuk ka propozimet që u parashtruan do t'i analizojmë si ekzekutiv dhe do t'i përcjellim për Kuvend.

Debati përfundoi në ora 15:46.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Drejtoresh për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi